

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GROELIDS sh.p.k”

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

Z. Elton Hyska, i datelindjes **19.07.1983**, e biri i Hasanit, lindur ne Sarande dhe banues ne rrugen Don Bosko, Pallati AK, Hyrja 3, Kati 7, Apartamenti 7, Njesia Bashkiake Nr.9, Tiranë, identifikuar me leternjoftim nr.034245433 dhe nr personal I30719095A madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “GROELIDS sh.p.k”

Sot me date **09.01.2025**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “GROELIDS sh.p.k” ka si objekt veprimtarie:

Aktivitete te projektimit inxhinierik dhe te gjitha llojet e projekteve qe lidhen me ndertimet civile, industriale dhe turistike. Studime Hidrologjike; Gjeologjike; Analiza Gjeoteknike; Matje Studime Gjeofizike, Sizmike; Rilevimetopografike, Plan Biznesi; Projektim Front-End (FEED) Llogaritje dhe Analiza; Projekti i Detajuar Elektrik; projekte Zbatimi per banesat rezidenciale dhe per ndërtesa turistike; objekte sportive; qendra tregtare, socio-kulturore; ndërtesa fetare; ndërtesaarsimi; qendra shëndetësore; terminale dhe infrastrukturë; struktura speciale; projektim dhe kompozim per hapësira të jashtme, menaxhimi i hapësirave të gjelbra, zhvillimi i parqeve .Interior Design; planifikim Urban Projektim i Peizazhit; Politikat dhe Strategjitë e Planifikimit; Studime Urbanistike Industriale dhe Ekonomike; Studime Urbanistike Turistike; Plane të Përgjithshme lokale Ndërlokale; Masterplane; supervizim, Zhvillim i një Plani të Menaxhimit të Cilësisë së Projektit; Administrim të punëve civile; Mbikëqyrja e ekzekutimit të punimeve; Matjet në terren të punimeve; Testime; Inspektim dhe vlerësim i pajisjeve; Kryerja e testeve/kontrollove të pavarura; Skedulimi; Mbikëqyrja e çdo lloj instalimi mekanik dhe elektrik; Shërbimet e Auditimit të Mjedisit; Monitorimi i zbatimit të ESMP; Inspektimi i HSE; Rishikimi i dokumentacionit; Inspektimi i materialeve dhe cilësisë së punimeve; Miratimi i Nënkontraktimit të çdo pjese të punës, Zgjatjes së kohës së mbarimit të punimeve, Materialeve dhe cilësisë së punimeve, Vizatimeve të punëve të ndërtimit , Programit të punëve dhe burimit të materialeve, Vleresim pasurish , Aktqendrueshmerie, Kolaudim, Eficence energjie: Raport auditimi ne ndertesa paraprake dhe perfundimtare, Menaxhim energjie dhe konsulence per shfrytëzim te energjise ne menyre optimale, konsultime me publikun, plane mobiliteti, aktivitete qe lidhen me mobilitetin , siguria rrugore, organizime ne panairë ne fusha te ndryshme, Mnzsh, ndermjetesim per shitblerjen, dhenien e marrjen me qira dhe menaxhimin e pasurive te paluajtshme, montimet e konstruksionet metalike si dhe cdo

ndertim tjetër i cili në përfundim, përben send të paluajtshëm. Projektimin dhe instalimin e sistemeve të sigurisë, Projektim dhe instalim në fushën e telekomunikacioneve mjeteve të sistemit vërtetues, sinjalizues audioviziv, mjeteve të mbrojtjes kundër zjarrit, pajisjeve të ndërlidhjes të teknikave të tjera të lejuara nga legjislati, instalimin dhe tregtimin e filmit të sigurisë së xhamit si dhe projektimin, instalimin dhe programimin e pajisjeve të telekomunikacionit, radio komunikacionit dhe sistemeve të kontrollit dhe monitorimit në distancë të automjeteve etj. Studim fizibiliteti, për ndërtim të impianteve fotovoltaike dhe ndërtim të impianteve fotovoltaike. Projekte të të gjitha llojeve, rikonstruksione, restaurime, ndërtime të të gjitha llojeve, Real estate me të gjithë elementet e saj. Blerje dhe shitje mallrash, Shërbime konsulente të ndryshme, Punime hidraulike, hidrike dhe instalimesh të të gjitha llojeve. Akt ekspertizë në ndërtime civile, industriale dhe turistike. Import-eksport i artikujve të ndryshëm. Import-eksport i mjeteve motorrike. Çdo veprim tjetër financiar e tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislatin në fuqi. Projektim dhe montim i fasadave të ventiluara, fasadave strukturale, vetrata alumini dhe PVC.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqërisë

Ortakut vendosi që shoqëria të emërtohet “GROELIDS sh.p.k”.

Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Rrugë Eshref Frashëri, Pallati nr.3 (Pallati oficerëve), hyrja nr.3, Dytanë 1, Njësia Bashkiake Nr.9, Tiranë.

Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyrë përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislatit shqiptar në fuqi
2. Me vendim të ortakut mund të ndryshojë formën juridike të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa me të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislatit shqiptar.
3. Në këtë rast ortakut do të përshtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar, në organet kompetente shqiptare.
4. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.
5. Shoqëria do të ketë vullnet të saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut

1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në një shoqëri tjetër ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislatin shqiptar.

4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregetare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100,000.00 (njqind mije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaku i shoqerise eshte:

1. **Elton Hyska**, zoterues i 1(nje) kuote me vlere 100,000.00 **(njqind mije) Lek**, qe perfaqeson **100% (njqind %)** kapitalin themeltar te shoqerise;

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Elton Hyska** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.

Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te tij, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.

Ky Akt shtypet dhe nenshkruset ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.

Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku Themelues

Elton Hyska